

PDK-ja mbështet protestën e 7 gushtit për çlirimtarët, fton qytetarët të marrin pjesë I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇFARË PRITET NGA GJYKATA KUSHTETUESE?

I FAQE 4-5



Gjykata Kushtetuese duhet ta sqarojë me terma të prerë mënyrën e votimit të kryetarit të Kuvendit të Kosovës si dhe të tregojë se afati 30-ditor për konstitu-

imin e Kuvendit nuk është konsumuar. Kështu vlerëson Zahir Çerkini, profesor i të Drejtës Kushtetuese në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë. Ai pret që

Gjykata Kushtetuese ta rritë se zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit duhet të bëhet me votim të hapur të deputetëve

HAXHIU: PRANIMI I PROVAVE NGA SERBIA NË SPECIALE, I GABUAR DHE I PAPRANUESHËM F. 8



HARGREAVES: MOSKONSTITUIMI I INSTITUCIONEVE, SITUATË 'SHUMË SERIOZE' PËR KOSOVËN F. 3



Safet GËRXHALIU



HAJDARI SËRISH MBROHET NË HESHTJE PËR RASTIN E "REZERVAVE SHTETËRORE" F. 8

SPORT



KUKA: NGA TË RINJTË PO KËRKOJMË REZULTATE, POR NUK PO U OFROJMË KUSHTE F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi vendos tarifë 25 % ndaj Indisë dhe paralajmëron taksë shtesë për naftën ruse

UASHINGTON, 31 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, njoftoi se do të vendosë një tarifë prej 25-përqindësh ndaj mallrave nga India si dhe një taksë shtesë për shkak të blerjeve që ky vend bën nga Rusia për naftë. Në platformën e tij "Truth Social", Trumpi tha se India "është miku ynë", por shtoi se

"tarifat e saj janë shumë të larta" për produktet amerikane. Sipas tij, India blen pajisje ushtarake dhe naftë nga Rusia - veprime që, sipas Trumpit, e ndihmojnë Rusinë ta vazhdojë luftën në Ukrainë. Për këtë arsye, ai tha se nga e premtdja do ta nisë zbatimin e një "dënimi" shtesë si pjesë e rishikimit të sistemit tarifor të

administratës së tij ndaj disa vendeve. Njoftimi vjen pas disa marrëveshjeve tregtare të negociuara me Bashkimin Evropian, Japoninë, Filipinet dhe Indonezinë - që Trumpi i cilësoi si hapa për hapjen e tregjeve për mallrat amerikane dhe për mundësinë që ShBA-ja t'i rrisë normat tatimore mbi importet.



Kanadaja u bashkohet Francës dhe Britanisë për njohje të shtetit palestinez

OTTAWA, 31 KORRIK - Kryeministri i Kanadasë, Mark Carney, ka thënë se shteti që udhëheq do ta njohë shtetin palestinez në shtator, duke u bërë vendi i tretë i grupit të shtatë shteteve më të industrializuara (G7) që bën një njoftim të tillë në ditët e fundit. Carney ka thënë se marrja e këtij vendimi do të varet nga reformat që do të kryhen, përfshirë zotimin e Autoritetit Palestinez që t'i mbajë zgjedhjet e reja vitin e ardhshëm, pa pjesëmarrje të Hamasit. Hamasit është grup palestinez i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi të tjera. Deklaratat e tij vijnë një ditë pasi Mbretëria e Bashkuar ka thënë se do ta njohë shtetin palestinez në shtator, përveç nëse Izraeli pajtohet për armëpushim dhe kushte të tjera. Një javë më parë edhe Franca e ka paraqitur një plan të ngjashëm. Presidenti amerikan Donald



Trump ka thënë se do të jetë "shumë e vështirë" të arrihet një marrëveshje tregtare me Kanadanë, pasi kryeministri Carney i ka bërë publike planet për njohjen e shtetit palestinez. Ministria e Jashtme e Izraelit e ka kundërshtuar njoftimin e Kanadasë, duke e quajtur "shpërblim për Hamasin". Prej 193 vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara, shtetin

palestinez e njohin zyrtarisht 147 sosh. Carney ka thënë se Kanadaja do ta njohë zyrtarisht shtetin palestinez në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Ai e ka përmendur zgjerimin e vendbanimeve izraelite në Bregun e pushtuar Perëndimor, përkeqësimin e situatës së sigurisë në Gazë dhe sulmin e 7 tetorit të vitit 2023 të

Hamasit kundër Izraelit, si arsye pas ndryshimit dramatik të politikës së jashtme të Kanadasë. "Niveli i vuajtjeve njerëzore në Gazë është i patolerueshëm dhe është duke u përkeqësuar me shpejtësi", ka thënë Carney para gazetarëve. Ai ka thënë se njohja e shtetësisë palestineze do të bëhet bashkë me përkushtimet e palës tjetër që të reformohet dhe ta çmilitarizojë territorin. Carney ka thënë në konferencë për medie se ka biseduar me presidentin e Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas, lidhur me vendimin e marrë. Autoriteti palestinez kontrollon pjesë të Bregut Perëndimor përmes partisë Fatah, e udhëhequr nga Abbasi, derisa Gazën e ka udhëhequr Hamasit. Asnjëri prej këtyre territoreve nuk ka mbajtur zgjedhje që prej vitit 2006. Izraeli e ka nisur fushatën ushtarake në Gazë në përgjigje të

sulmit të kryer nga Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor 2023 si pasojë e të cilit janë vrarë 1 200 njerëz dhe janë marrë peng rreth 240 të tjerë. Sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, mbi 59 000 palestinezë janë vrarë në Gazë prej atëherë. Pjesa më e madhe e Gazës tani është shndërruar në gërmadhë. Agjencia e OKB-së për Refugjatë Palestinezë (UNRWA) ka thënë se një në pesë fëmijë në qytetin e Gazës tani është i kequshqyer dhe që numri i rasteve po rritet çdo ditë. Mbi 100 organizata ndërkombëtare të ndihmës dhe grupe për të drejta të njeriut kanë paralajmëruar për urë masive në Rripin e Gazës, duke u bërë presion qeverive në botë që të veprojnë. Izraeli, i cili kontrollon hyrjen e të gjitha furnizimeve në Gazë, përsërit se nuk ka rrethim dhe e fajëson Hamasin për çdo rast të kequshqyerjes.

Ukraina rikthen pavarësinë e agjencive kundër korrupsionit

KIEV, 31 KORRIK - Turma protestuesish janë parë duke brohoritur me gëzim të enjten në Kiev, teksa e kanë shikuar një ekran të madh, në të cilin është konfirmuar që Parlamenti ukrainas e ka miratuar legjislacionin e ri për rikthim të pavarësisë së agjencive kundërkorrupsionit. Legjislacioni është miratuar me 331 vota për dhe asnjë kundër. Vendimi është marrë pasi një ligj - që dyshohej se do të mund t'i kufizonte hetimet për korrupsion - është miratuar një javë më parë, dhe i ka nxitur protestat më të mëdha prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, mbi tre vjet më parë. Ligji i ri e rikthen pavarësinë e Byrosë Kombëtare të Ukrainës Kundër-Korrupsionit dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar për rastet e korrupsionit. Ligji duhet të miratohet nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky për të hyrë në fuqi.

Zelensky, i cili e ka nënshkruar legjislacionin original më 22 korrik, ka thënë se qëllimi i ligjit ka qenë që agjencitë të çlirohen nga ndikimi rus, që i ka bërë të cënueshme ndaj korrupsionit për kohë të gjatë. Mirëpo limitet në pavarësinë e tyre i kanë zemëruar shumë ukrainas - sidomos të rinjtë - të cilët menjëherë kanë organizuar protesta, pavarësisht se raketat dhe dronët rusë kanë vazhduar të shënjestrojnë Kievin dhe qytetet e tjera. "Njerëzit nuk e kanë pritur që të rinjtë do të dalin kaq shumë", ka thënë Anastasia Bezpalko, një prej qindra personave që kanë dalë në rrugë gjatë javës së fundit. "Të rinjtë e kanë kuptuar se dikush ka tentuar t'i mashtrojë, prandaj është nxitur kjo ndjesi e theksuar e padrejtësisë", ka thënë 23-vjeçarja për "Radion Evropa e Lirë". Zelensky ka propozuar që ligji i ri të paraqitet më 31 korrik, duke thënë se e ka dëgjuar zërin e



popullit dhe që dokumenti i ri do t'i adresojë shqetësimet për ndikim rus, por nuk do ta rrezikojë pavarësinë e këtyre agjencive. Ndihmësi i Zelenskyt, Andriy Yermak, e ka mirëpritur votimin.

"E kemi një shoqëri civile të mrekullueshme, rini të mrekullueshme, të cilën e dëgjoj presidenti Zelensky. Ky ishte një dialog i shpejtë në mes të autoriteteve dhe shoqërisë", ka thënë ai në rrjete sociale.

Kryeministrja e sapoemëruar, Yulia Svyrdydenko, ka thënë se "kjo është përgjigje direkte dhe e përgjegjshme ndaj pritjeve të shoqërisë ukrainase dhe partnerëve tanë evropianë". Korrupsioni i shtrirë thellë në Ukrainë e ka penguar mbështetjen për Kievin në disa qarqe perëndimore. Protestat janë zhvilluar teksa Ukraina i ka sytë drejt Shteteve të Bashkuara dhe aleatë të tjerë perëndimorë për t'i bërë presion Rusisë që të angazhohet në bisedimet për paqe dhe t'i japë fund luftës së nisur nga Moska në shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

HARGREAVES: MOSKONSTITUIMI I INSTITUCIONEVE, SITUATË ‘SHUMË SERIOZE’ PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, derisa ka komentuar moskonstituimin e institucioneve të Kosovës, as pesë muaj pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, ka vlerësuar se kjo situatë është “shumë serioze” për Kosovën. “Kjo është një krizë jo vetëm politike. Unë besoj se ky është një moment shumë serioz për Kosovën”, tha ai në një intervistë për mediumin serb me seli në Kosovë, Radio Gorazdevac. Sipas tij, Kosova ka nevojë “urgjente” për një qeveri dhe parlament të konstituuar, i aftë për të marrë “vendime të rëndësishme në lidhje me vendin”.

I pyetur për masën e Gjykatës Kushtetuese e cila e pezulloj punën e Kuvendit të Kosovës deri më 8 gusht, diplomati britanik tha se shpreson se Kushtetuesja “do ta zgjidhë këtë çështje”. “Por, në fund të fundit, kjo duhet të zgjidhet politikisht - me anë të kompromisit midis partive

politike. Kushtetuta dhe ligji mund të ofrojnë një kornizë, por u takon palëve të bien dakord se si të vazhdojnë”, ka shtuar ai.

Duke folur për zgjedhjet lokale të 12 tetorit, Hargreaves vlerësoi se kjo datë përfaqëson një shans për të gjitha komunitetet, veçanërisht atë serbe. “Është një mundësi për të gjitha komunitetet në Kosovë - përfshirë komunitetet joshumicë, veçanërisht komunitetin serb - që ta shprehin vullnetin e tyre dhe të përfaqësohen nga parti që vërtet duan t'i mbrojnë qytetarët”.

Në këtë kontekst, Hargreave potencoi se Lista Serbe është pjesë legjitime e sistemit politik të Kosovës. “Lista Serbe është një parti legjitime në sistemin politik të Kosovës. Është në Kuvend dhe është pjesë e procesit politik. Nuk është puna ime të them se sa mirë i përfaqëson të gjithë serbët e Kosovës. Komuniteti duhet të vendosë për këtë në zgjedhje”, ka thënë Hargreave.



NGA 12 TETORI BE-ja DO TA FILLOJË ZBATIMIN E SISTEMIT TË RI TË HYRJË-DALJEVE



PRISHTINË, 31 KORRIK - Nga data 12 tetor Bashkimi Evropian do ta fillojë zbatimin gradual të sistemit të ri të hyrje-daljeve (Entry/Exit System - EES). Këto rregulla fillimisht do të futen për gjashtë muaj. Ky sistem vlen për të gjithë udhëtarët e vendeve që nuk janë në BE, pra të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, britanikët dhe shtetasit e vendeve të tjera, pavarësisht se a udhëtojnë privatisht si turistë apo për biznes.

EES është pjesë e programit që synon përshtetimin e procedurave të hyrjes për udhëtarët e rregullt dhe forcon kontrollin ndaj emigracionit të parregullt, shkruan gazetari i

“Deutsche Welle”, Bahri Cani. Gjatë kësaj periudhe autoritetet kufitare në vendet anëtare do të fillojnë t'i regjistrojnë të dhënat e udhëtarëve nga vendet e treta, përfshirë gjurmët e gishtave, fotografitë e fytyrës dhe të dhëna të tjera të udhëtimit. Ky sistem do ta zëvendësojë në mënyrë graduale procesin aktual të vulosjes së pasaportave.

Pikat kufitare po përgatiten për zbatimin e sistemit, me pajisje për gjurmët e gishtave që tashmë janë vendosur në terminalin Eurostar në Londër dhe me ndërtimin e kioskave për pasagjerët me automjete, autobusë apo kamionë në

Dover. “Në hyrjen e parë në një vend të BE-së pasagjerët do t'i nënshtrohen regjistrimit biometrik përmes gjurmëve të gishtave ose një skanimi të fytyrës. Pas futjes në sistem, shtetasit britanikë dhe udhëtarët e vendeve të tjera jashtë BE-së nuk do të kenë më nevojë për vulosje në pasaportë. Ky sistem do t'u mundësojë autoriteteve të verifikojnë menjëherë nëse një pasagjer ka tejkaluar afatin e qëndrimit të lejuar. Sa i përket qëndrimit në BE, me siguri e dini, por po e përsëris: Secili ka të drejtë të qëndrojë tre muaj brenda gjashtë muajve në Zonën Shengen”, ka theksuar Cani.

700 punëtorë pa paga, Sindikata e RTK-së: Protesta e 6 gushtit, e pashmangshme

PRISHTINË, 31 KORRIK - Sindikata e Punëtorëve e Radio Televizionit të Kosovës (RTK-së) ka thënë se mbi 700 punëtorë të mediumit publik kanë mbetur pa paga, duke shprehur shqetësim rreth kësaj situate.

Sindikata e RTK-së ka vlerësuar se kjo situatë është jashtëzakonisht e rëndë dhe krejtësisht e papranueshme për ta. “Sindikata e Punëtorëve të RTK-së shpreh shqetësimin e thellë që edhe sot, më 31 korrik, kur përfundon muaji, mediumi publik i vendit mbetet pa

financim, duke lënë pa paga mbi 700 punëtorë dhe familjet e tyre. Kjo situatë është jashtëzakonisht e rëndë dhe krejtësisht e papranueshme për Sindikatën. Në nuk mund të pranojmë që punëtorët e RTK-së, të cilët çdo ditë mbajnë të informuar qytetarët e Republikës së Kosovës, të mbeten pa të ardhura për shkak të neglizhencës institucionale. Edhe njëherë u bëjmë thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse që të ndërhyjnë urgjentisht për të gjetur një zgjidhje për

situatën dhe të garantojnë pagat e punëtorëve tanë. Protesta e paralajmëruar për datën 6 gusht mbetet e pashmangshme. Ju bëjmë thirrje të gjithë kolegëve që të jenë të pranishëm dhe të bashkuar në këtë protestë. Për detajet e protestës së 6 gushtit, të cilën e kemi bërë publike edhe përmes konferencës për media disa ditë më parë, shumë shpejt do t'i bëjmë publike edhe pikat e veprimit dhe detajet organizative”, thuhet në reagimin e Sindikatës së RTK-së.





ÇFARË PRITET NGA GJYKATA KUSHTETUESE?

PRISHTINË, 31 KORRIK - Gjykata Kushtetuese duhet ta sqarojë me terma të prerë mënyrën e votimit të kryetarit të Kuvendit të Kosovës si dhe të tregojë se afati 30-ditor për konstituimin e Kuvendit nuk është konsumuar. Kështu vlerëson Zahir Çerkini, profesor i të Drejtës Kushtetuese në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Ai pret që Gjykata Kushtetuese ta ritheksojë se zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit duhet të bëhet me votim të hapur të deputetëve. “Kështu edhe e tha Gjykata (më 26 qershor), por e tha me terma më kushtetues. Pres të jetë më e hapur, më e artikuluar në drejtim të obligimit që institucionet të ulen dhe të votojnë në mënyrë të hapur për konstituimin e Kuvendit, zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit”, thekson Çerkini për Radion Evropë e Lirë. Për t’i sqaruar çështjet kushtetuese lidhur me konstituimin e Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese i janë drejtuar Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe presidentja e vendit, Vjosa Osmani. Ata janë në pritje të një vlerësimi të ri të Gjykatës Kushtetuese, pasi vendimi i saj i 26 qershorit nuk arriti ta sqaronte në mënyrë të prerë rrugën për

konstituimin e Kuvendit. Gjykata Kushtetuese më 26 qershor u dha 30 ditë afat deputetëve të Kuvendit të Kosovës për konstituimin e Kuvendit. Por, pas 52 përpjekjeve, ata nuk arritën ta përmbyllin këtë proces. Presidentja e Kosovës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese sqarimin e pasojave juridike të moskonstituimit të Kuvendit brenda afatit kushtetues prej 30 ditësh. Kërkesa është regjistruar si lëndë e veçantë nga ana e gjykatës. Çerkini shpreh mendimin se Gjykata Kushtetuese duhet ta konfirmojë se ky afat duhet të rikthehet në pikën e rrjedhjes, aty ku rendi i ditës së seancës ka devijuar. “Pres nga Gjykata Kushtetuese që të tregojë se afati 30 ditësh nuk është konsumuar ende, për faktin se nuk është shkuar në atë që ka thënë Gjykata, pra që të shkohet në votim për zgjedhjen e kryesisë së Kuvendit, pra për konstituimin e Kuvendit, por vazhdimisht është tentuar që të votohet Komisioni (për votim të fshehtë)”, thotë Çerkini. Sipas tij, kjo nënkupton që afati i caktuar nga Gjykata Kushtetuese për konstituimin e Kuvendit të rikthehet në proces e sipër, në ditën kur kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, ka ndryshuar rendin e ditës, duke kërkuar votimin e Komisionit për

Votim të Fshehtë. Idenë e Komisionit për Votim të Fshehtë, Dehari e propozoi më 1 maj, duke u kërkuar partive politike nga një anëtar për komisionin për votimin e fshehtë. Deri atëherë, në vazhdimet e seancës konstituive të Kuvendit, e cila nisi më 15 prill, e propozuara nga Lëvizja Vetëvendosje për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, disa herë nuk arriti t’i marrë 61 votat e nevojshme të deputetëve për këtë pozitë përmes votimit të hapur. Partitë e tjera kryesore, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në vazhdimësi kanë refuzuar votimin e fshehtë dhe propozimin e anëtarëve për Komisionin për Votim të Fshehtë. Më 24 korrik Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme, që nënkupton se nga 27 korriku deri më 8 gusht deputetët nuk duhet të veprojnë për ta konstituuar Kuvendin e Kosovës.

Veprimet e Deharit dhe kandidatura e përsëritur

Në fillim të korrikut PDK-ja i është drejtuar për vlerësim Gjykatës Kushtetuese, duke kontestuar kërkesën e Lëvizjes

Vetëvendosje për propozime për anëtarë të Komisionit për Votim të Fshehtë; hedhjen në votim të këtij komisioni; vetë votimin e komisionit; si dhe ndërprerjen e seancës pas mosmiratimit të komisionit. Po ashtu, LDK-ja i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese t’i sqarojë normat kushtetuese dhe të rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës në lidhje me vazhdimin e seancës konstituive nga 29 qershori pas aktgjykimit të 26 qershorit. Kjo parti beson se vazhdimet e fundit të seancës konstituive janë bërë “në kundërshtim të plotë” me Kushtetutën e Kosovës si dhe me konstatimet e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese nga 26 qershori. Gëzim Shala nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) thotë për “Radion Evropë e Lirë” se nga Gjykata Kushtetuese pret ta vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e veprimit të kryesuesit të seancës konstituive të Kuvendit. “Duhet sqaruar në mënyrë të prerë edhe veprimet e zotit Dehari, në cilësinë e kryesuesit të seancës së Kuvendit, për t’i përcaktuar dhe elaboruar shkeljet e bëra prej tij deri më tani”, thekson Shala. Ai shton se Gjykata Kushtetuese duhet ta elaborojë çështjen e të drejtës së propozimit të

mandatarit për kryetar të Kuvendit, përkatësisht nëse Lëvizja Vetëvendosje, si parti me më së shumti vota, ka keqpërdorur këtë të drejtë duke propozuar në vazhdimësi të njëjtin emër, pavarësisht se nuk i ka siguruar votat e nevojshme për miratim. “Gjykata Kushtetuese e ka theksuar se në këto raste kërkohet që të ketë kompromis për të vazhduar tutje dhe thjesht, Gjykata tash duhet të tregojë se si duhet proceduar tutje nëse nuk ka kompromis”, thekson Shala. Mendim të ngjashëm ka edhe profesor Çerkini, i cili thotë se Gjykata Kushtetuese duhet të përcaktojë qartë se çfarë ndodh në rast se kandidati i njëjtë për kryetar të Kuvendit nuk i merr votat në disa tentime radhazi. “Për të dalë nga kjo situatë është mirë që Gjykata Kushtetuese mbase të tregojë edhe me enumeracion pozitiv (përshtkrim konkret, me fakte dhe hollësi të numëruara njëra pas tjetrës) se sa herë një kandidat mund të jetë kandidat për kryetar të Kuvendit... të tregohet një numër i caktuar se sa herë, brenda sa ditësh, një emër mund të vendoset në kandidaturë”, thekson Çerkini. Ai shtoi se sqarimi i tillë nuk nënkupton humbjen e të drejtës së partisë së parë fituese për ta propozuar kryetarin e Kuvendit.

HAXHIU: PRANIMI I PROVAVE NGA SERBIA NË SPECIALE, I GABUAR DHE I PAPRANUESHËM

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka shprehur shqetësim për faktin se Dhomat e Specializuara në Hagë kanë pranuar si prova materiale dokumente të dorëzuara nga institucionet shtetërore të Serbisë, përfshirë Departamentin e Sigurisë Shtetërore, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të ashtuquajturën “Komandë për Kosovën dhe Metohinë”. Haxhiu ka shkruar në

“Facebook” se ky zhvillim është thellësisht i papranueshëm. “Institucionet në fjalë janë struktura të një regjimi që ka qenë përgjegjës për dhunë sistematike, krime lufte, zhdukje me forcë, gjenocid, spastrime etnike dhe represion brutal ndaj popullit të Kosovës. Pranimi i materialeve të prodhuara nga ky regjim si burime të besueshme përbën një deformim të rëndë të drejtësisë dhe një fyerje të hapur ndaj viktimave të luftës dhe sakrificës për liri”, ka thënë Haxhiu, duke shtuar se tentimi i gjykatës, me një fjali sikur “për

më tepër, fakti që disa Prova të Propozuara vijnë nga autoritetet serbe nuk përbën, në vetvete, një ndalesë për pranimin e tyre’ (par. 17), përveç të tjerash, është edhe juridikisht i gabuar dhe i padrejtë”. “Ky pretendim tronditës bie ndesh me praktika të etabluara të drejtësisë penale ndërkombëtare, sipas të cilave një ndër kriteret më të rëndësishme për vlerësimin e pranueshmërisë së provave është nëse burimi i tyre ka një interes në rezultatit e procesit apo ka indikatorë të tjerë të anshmërisë. Refuzimi i Gjykatës

për ta marrë parasysh këtë kriter, ngre dyshime serioze mbi paanshmërinë e vetë gjyqtarëve të rastit”, është shprehur Haxhiu. Ajo ka theksuar se përdorimi i dokumenteve të prodhuara nga institucionet e regjimit serb është i gabuar dhe i papranueshëm. “Nuk mund të ketë besim në dokumente që janë prodhuar nga një aparat shtetëror kriminal, jo për të ndërtuar drejtësi, por për të manipuluar të vërtetën, për të fajësuar viktimën dhe për të amnistuar kriminelin. Slobodan Millosheviqi dhe

bashkëpunëtorët e tij janë gjykuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës për krime lufte. Pranimi i dokumenteve të prodhuara nga regjimi i tyre nga një gjykatë që vepron në emër të Republikës së Kosovës e zhvesh këtë gjykatë nga legjitimiteti kushtetues dhe e shndërron atë në instrument të logjikës së vjetër të mohimit të së vërtetës, barazimit të palëve dhe relativizimit të krimeve. Kjo është jo vetëm e padrejtë, por politikisht e papranueshme”, ka thënë ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.



Kushtetuesja “t'i përjashtojë zgjedhjet”

Në pamundësi për t'i siguruar votat për kryetare të Kuvendit, deputetja e Lëvizjes vetëvendosje, Albulena Haxhiu, qysh në muajin qershor hodhi idenë për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, bashkë me ato lokale, më vonë këtë vit. Kjo ide u përsërit edhe nga kolegja e saj partiake, Mimoza Kusari-Lila, e cila duke potencuar hezitimin e partive të caktuara për bashkëqeverisje, ka thënë se zgjidhje mund të jenë zgjedhjet e

parakohshme. Ajo, gjithashtu, e ka përmendur mundësinë e marrjes së mandatit të deputetëve të Kuvendit si pasojë e pamundësisë që ta konstituojnë Kuvendin. Mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, për shkak të bllokimit të konstituimit të Kuvendit, është parë si opsion i mundshëm edhe nga Partia Demokratike e Kosovës. Por, lideri i saj, Memli Krasniq, ka përjashtuar mundësinë që ato të mbahen bashkë me ato lokale këtë vit. LDK-ja nuk e ka përmendur mundësinë e zgjedhjeve të

parakohshme, ndërsa AAK-ja ka thënë se nuk i kërkon ato, por është e gatshme nëse zgjedhjet mbahen. Profesor Çerkini thekson se Gjykata Kushtetuese nuk duhet fare të merret me këtë ide. “Idenë se a mund t'u merret mandati deputetëve nga ana e Gjykatës Kushtetuese, duke e dërguar vendin në zgjedhje... unë mendoj se Gjykata nuk duhet ta bëjë një gjë të tillë. Nuk i takon Gjykatës Kushtetuese të ndërhyjë në pushtetin politik për ta dërguar vendin në zgjedhje”, thotë Çerkini. Me këtë pikëpamje pajtohet edhe Shala nga IKD-ja. Sipas tij,

moskonstituimi i Kuvendit nuk është rrethanë e paraparë në Kushtetutën e Kosovës e cila do ta përcaktonte marrjen e mandateve të deputetëve. Edhe pse nuk dihet saktësisht se cili do të jetë vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Shala thotë se praktikata nga vendimmarrjet e kaluara të kësaj gjykate tregojnë se nuk mund të ketë zgjedhje të reja përmes aktgjykimeve të saj. “Vetë Gjykata Kushtetuese më 2014 ka thënë se askund në Kushtetutë nuk thuhet se moszgjedhja e kryetarit të Kuvendit e çon vendin në zgjedhje, mirëpo nuk e dimë nëse Gjykata Kushtetuese do ta

ndërron praktikën”, thekson Shala. Të dy njohësit e çështjeve juridike - kushtetuese - vlerësojnë se mbetet e pasigurt se kur Gjykata Kushtetuese mund të dalë me sqarime lidhur me kërkesat e parashtruara në adresë të saj nga PDK-ja dhe LDK-ja si dhe nga presidentja Osmani. Megjithatë, marrë parasysh që më 8 gusht skadon afati i masës së përkohshme të Gjykatës Kushtetuese, e cila ndalon veprimin e deputetëve në drejtim të konstituimit të Kuvendit, ata presin që një vendim i kësaj gjykate mund të shpallet para kësaj date.

KMDLNJ MBËSHTET PROTESTËN E 7 GUSHTIT KUNDËR PADREJTËSIVE NGA GJYKATA SPECIALE

PRISHTINË, 31 KORRIK - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka shprehur mbështetje për protestën e paralajmëruar më 7 gusht 2025 nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së kundër Gjykatës Speciale në Hagë. Në reagimin e saj, KMDLNj-ja ka theksuar se kjo gjykatë është duke vepruar në

kundërshtim me të drejtat e njeriut, duke pranuar prova të dyshimta nga institucionet e sigurisë së Serbisë dhe duke zbatuar standarde diskriminuese ndaj të akuzuarve shqiptarë. Sipas KMDLNj-së, arrestimet dhe gjykimet janë të motivuara politikisht, ndërsa Qeveria e Kosovës është kritikuar për mungesë të angazhimit për

mbrojtjen e të akuzuarve dhe për ndryshime ligjore që kanë kufizuar mundësitë e mbrojtjes efektive. KMDLNj-ja ka kërkuar proces të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht për të gjithë të akuzuarit dhe i fton qytetarët të protestojnë kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe cenimit të prezumimit të pafajësisë.



MILLOSH PLESKOVIQ DËNOHET ME 15 VJET BURGIM PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

PRISHTINË, 31 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar të enjten Millosh Pleskoviçin me 15 vjet burgim për akuzat për krime lufte në Kosovë. Sipas aktakuzës, Pleskoviç bashkë me një grup serbësh të armatosur i kanë vrarë tre civilë shqiptarë dhe i kanë plagosur disa të tjerë në qytetin e Prizrenit, raporton “Betimi për Drejtësi”. Gjykatësi Rrahman Beqiri ka thënë të enjten se vendimi do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e aktgjykimit. Pleskoviç veçse ka qenë nën masë të paraburgimit. Sipas aktakuzës, Pleskoviç kishte gjuajtur me armë të tipit “Kallashnikov” e nga të shtënat në vendin e ngjarjes kishin mbetur të vrarë R. D., B. D., dhe F. B., kurse të dëmtuarit Xhenger Cana, Fevzi Cana dhe Bashkim Kastrati kishin shpëtuar. Në dokument është përmendur se familjarëve të të ndjerëve u ishte lejuar t’i merrnin trupat e viktimave pas një jave nga



vrasja dhe që trupat e R. dhe B. D. ishin vendosur mbi njëri-tjetrit, kurse njëri nga ta e kishte këmbën e prerë, ndërkaq viktimat F. B. nuk e kishte kokën në trup. Gjatë luftës në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur. Rreth 1 600 persona, kryesisht shqiptarë, janë ende të zhdukur. Ndër vite, autoritetet e drejtësisë në Kosovë kanë akuzuar ose dënuar disa persona për krime lufte.

VETERANI I UÇK-së DORËZON KALLËZIM PENAL NDAJ FITORE PACOLLIT: JAM ÇLIRIMTAR, NUK JAM KRIMINEL

PRISHTINË, 31 KORRIK - Veterani i luftës së UÇK-së, Agim Pllashniku, ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore të Prishtinës ndaj deputetes së Vetëvendosjes, Fitore Pacolli, të cilin ditë më parë e kishte akuzuar për hajni në një lokal në kryeqytet. “Pacolli ka gabuar shumë. Më ka akuzuar mua, familjarët dhe mediet pse vajza ime po shkon

në intervistë, po e thirrin mediet, po e akuzon pse po e thirrni. Po thotë: ‘Po e thirrni një vajzë kriminele’. Unë dua t’i tregoj Fitores se nuk jam kriminel. Jam çlirimtar. Unë ia kam sjellë lirinë me shokët e mi. Ajo është hajneshë. Ajo ka vjedhë”, ka thënë Pllashniku. Pacolli ka postuar në “Facebook” se vajza e Agim Pllashnikut është kandidate për asambliste në

Prishtinë, duke aluduar se këto janë motivet mbrapa akuzave të Pllashnikut. Ky i fundit, kur u pyet nga gazetarët se nëse është vajza e tij pjesë e PSD-së, pohoi: “Po. Pse është vajza me PSD-në unë faj nuk kam. Është e vërtetë. Është kandidatë për asambliste. Ku e ka fatin komuna e Prishtinës ta zgjedhë vajzën time asambliste”, ka pohuar Pllashniku.



Vdes një person në Prizren, ra nga çatia e ndërtesës ku punonte

PRIZREN, 31 KORRIK - Një punëtor i sektorit të ndërtimtarisë ka vdekur pasi ka rënë nga çatia e ndërtesës ku po punonte. Për këtë rast mbikëqyrësi dhe investitori i punimeve janë intervistuar si të dyshuar dhe më pas janë ndaluar për 48 orë, tha Policia e Kosovës. Policia rajonale e Prizrenit tha se viktimat, N. Xh., rreth 40 vjeç, ishte nga Drenasi. Pasi ka rënë nga lartësia, ai është dërguar me urgjencë në spitalin rajonal të Prizrenit, por nuk u ka mbijetuar plagëve. “Policia i



është përgjigjur menjëherë rastit, duke ndërmarrë veprimet e para hetimore dhe

duke marrë dëshmi nga personat e pranishëm në vendngjarje”, u tha në njoftim.

Prokurori i Shtetit ka udhëzuar që për këtë rast të iniciohet procedura penale për veprën: “Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës”. Përveç rastit në Prizren, në ditët e fundit në Kosovë kanë vdekur pesë persona në vendet e punës, katër prej të cilëve nga aksidentet. Në Gjakovë dy persona humbën jetën në të njëjtin kantier ndërtimi. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës më herët

ka shprehur shqetësim për siç, ka thënë, kushtet e rënda me të cilat përballen punëtorët e ndërtimtarisë në punë. Në Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë theksohet se siguria, trajnimi i punëtorëve, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive janë obligime që duhet t’i zbatojë secili punëdhënës për të punësuarit e tij. Sipas raportit të Inspektoratit të Punës për vitin 2024, vitin që kemi lënë pas janë regjistruar shtatë raste të vdekjeve në vendet e punës.

Haxhiu thekson rëndësinë e rritjes së përfshirjes së të burgosurve në programe rehabilituese

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministri në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka zhvilluar takim pune me drejtuesit e institucioneve korrektuese, për ta vlerësuar përpërimin e arritur dhe të përt'i përcaktuar prioritetet e mëtejshme për institucionet korrektuese.

Gjatë takimit Haxhiu ka vlerësuar thellësisht përkushtimin e stafit korrektues, duke theksuar rëndësinë e rritjes së përfshirjes së të burgosurve në programe rehabilituese. “Në muajt e fundit është shënuar një

rritje e ndjeshme në këtë drejtim, gjë që dëshmon se po ecim drejt një sistemi korrektues që jo vetëm ndëshkon, por edhe ofron mundësi reale për integrim të qëndrueshëm në shoqëri. Një aspekt i rëndësishëm që diskutuam ishte përmirësimi i dukshëm i sigurisë brenda institucioneve korrektuese. Ulja e numrit të incidenteve tregon se masat parandaluese dhe vigjilenca e shtuar po japin rezultate konkrete. Theksova se këto arritje duhet të na motivojnë për

të vazhduar me politika të qëndrueshme dhe efikase në ruajtjen e rendit dhe sigurisë”, ka thënë Haxhiu.

Ajo ka nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat mbështetëse. “Falënderova të gjithë partnerët për kontributin e tyre të çmuar, duke theksuar se ndihma teknike, profesionale dhe financiare ka përmirësuar ndjeshëm kushtet e punës për stafin korrektues dhe mënyrën e trajtimit të të burgosurve”, ka deklaruar Haxhiu.



PDK-ja MBËSHTET PROTESTËN E 7 GUSHTIT PËR ÇLIRIMTARËT, FTON QYTETARËT TË MARRIN PJESË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka shprehur shqetësimin për zvarritjen e procesit gjyqësor ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Dhomat e Specializuara në Hagë. Ai ka theksuar se më shumë se katër vjet e gjysmë pas paraburgimit të tyre, ende nuk ka një vendim përfundimtar, ndërsa ka

ngritur alarmin për shkelje të standardeve të drejtësisë.

Krasniqi ka thënë se në këtë frymë mbështesin protestën e ftuar nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së si një shprehje demokratike e qëndrimit qytetar, por edhe si bindje për pafajësinë e të akuzuarve. “Prej më shumë se katër vjetësh e gjysmë udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndodhen në paraburgim në Dhomat e Specializuara ende pa një vendim përfundimtar. Zvarritja e këtij procesi dhe shmangia



nga standardet e pritura të drejtësisë, të cilat kanë ndodhur nga kjo gjykatë, kanë ngritur shqetësime serioze jo

vetëm për të drejtat e të akuzuarve, por edhe për besimin e qytetarëve në vetë drejtësinë. Këto shqetësime janë thelluar edhe më tej pas raportimeve të fundit se kjo gjykatë po mbështetet në prova të fabrikuara nga strukturat shtetërore të Serbisë. Partia Demokratike e Kosovës ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë në mbështetje të luftës për liri dhe të së drejtës për një proces të drejtë, të paanshëm dhe të shpejtë për çlirimtarët tanë. Në këtë frymë, mbështesim

protestën e ftuar nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, si një shprehje demokratike e qëndrimit qytetar, por edhe si bindje për pafajësinë e të akuzuarve. Ftoj të gjithë qytetarët që besojnë në drejtësinë e luftës sonë për liri, në dinjitetin dhe të ardhmen e Republikës së Kosovës, që t'i bashkohen kësaj proteste më 7 gusht, në orën 17:00, në sheshin ‘Skënderbeu’. Me çlirimtarët. Për drejtësi. Për Kosovën”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

KRASNIQI DHE SVEÇLA SHOHIN NGJA AFËR PUNIMET PËR NDËRTIMIN E URAVE NË MITROVICË

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka vizituar punimet në urën e Mitrovicës. Krasniqi ka thënë se punimet po zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar. “Vizituam kantierin e punimeve të urës. Punimet po zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar. Për urat që lidhin qytetin dhe projektet që kontribuojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, Qeveria mbetet e përkushtuar për përmirësimin e



infrastrukturës”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, më 1 korrik ka marrë pjesë në vendosjen e themeleve të dy urave të reja mbi lumin Ibër në Mitrovicë.

Ura e re për kalimin e automjeteve dhe këmbësorëve do të ketë një gjatësi prej 51 metrash, një gjerësi prej 10 metrash, nga të cilat 3 metra trotuar (nga 1.5 metra në të dyja anët), ndërsa ura tjetër, vetëm për kalimin e këmbësorëve, do të ketë një gjatësi prej 41 metrash dhe një gjerësi prej 37 metrash.

Këto dy projekte janë rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe dy komunave të qytetit të Mitrovicës. Vlera e tyre totale është rreth tre milionë euro. Punimet pritet të përfundojnë deri në vjeshtë.

Me këtë rast, Kurti theksoi se duke ndërtuar këto ura po tregojnë përkushtimin për të pasur sa më shumë komunikim, qarkullim, bashkëpunim dhe shkëmbime ndërmjet veriut dhe jugut.

ZKA dhe Instituti AAB nënshkruajnë marrëveshje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

PRISHTINË, 31 KORRIK - Auditorja e përgjithshme, Viora Spanca dhe drejtori i ekzekutiv i Institutit AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar, Ylber Prekazi, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit që ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të stafit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) nëpërmjet programit të

Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP). Marrëveshja do të zgjasë për një periudhë 24-mujore dhe përfshin organizimin e trajnimeve vjetore prej së paku 12 orësh për auditorët e ZKA-së, në fusha kyçe të kontabilitetit dhe auditimit. Vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së dhe Institutit AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar

synon ngritjen e vazhdueshme të njohurive dhe aftësive profesionale të auditorëve, promovimin e praktikave të mira dhe rritjen e cilësisë në auditim. Po ashtu, dëshmon përkushtimin e ZKA-së për të investuar në zhvillimin profesional të stafit të saj dhe për të siguruar standarde të larta të cilësisë në funksion të auditimit publik në Kosovë.



HAJDARI SËRISH MBROHET NË HESHTJE PËR RASTIN E REZERVAVE SHTETËRORE

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministrija në detyrë e Industrisë, Rozeta Hajdari, të enjten është intervistuar në cilësinë e të pandehurës nga Prokuroria Speciale në çështjen e “Rezervave shtetërore”, ka bërë me dije zëdhënësja e Prokurorisë, Arbnora Luta. Hajdari gjatë intervistimit ka shfrytëzuar të drejtën “për t’u mbrojtur në heshtje” sikurse kishte bërë gjatë thirrjes së parë këtë çështje. “Rozeta Hajdari është ftuar për t’u deklaruar në cilësinë e të pandehurës në kuadër të hetimeve për rastin ‘Rezervat shtetërore’. Thirrja është bërë me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike për të gjitha dyshimet që janë pjesë e hetimit”, ka thënë Luta. Ndërsa pas përfundimit të intervistimit, në një prononcim për medie, Hajdari akuzoi Prokurorinë Speciale për ndërhyrje të paligjshme gjatë hetimeve për rezervat shtetërore, duke pretenduar se hetuesit nuk kanë pasur certifikatat e nevojshme të sigurisë për të pasur qasje në dokumentet që

klasifikohen si sekret shtetëror. “Prokuroria Speciale ka bërë gabim - një hap të pamenduar mirë - duke dërguar dy policë hetues pa certifikatë sigurie dhe duke marrë dokumente brenda një ore në Ministrinë e Industrisë”, ka deklaruar Hajdari pas intervistimit nga Prokuroria Speciale. Hajdari e ka akuzuar prokurorin special, Valdet Gashi, për shkelje të ligjit dhe konflikt interesi. Ajo ka pretenduar se prokurori Gashi ka mbrojtur hetuesit që kanë hyrë në ministri pa certifikatë sigurie të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Informacione të Klasifikuara (AMIK) për të marrë dokumente. “Për më shumë, ne si ministri kemi iniciuar një hetim të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për të iniciuar një hetim dhe për të ardhur në konstatim të kësaj shkeljeje të këtij konflikti të interesit, sepse e kemi të dokumentuar në raportin e Inspektoratit Policor, ku prokurori Gashi pranon konfliktin e interesit për ta shqyrtuar këtë raport të IPK-së”, ka thënë Hajdari.



MIKROFINANCA PO TRANSFORMON DHE NDIKON NË KOSOVË, NGA IDE TË VOGLA NË NDRYSHIME TË MËDHA



Safet GËRXXHALIU

Pasojat e krizës ekonomike globale e në veçanti rritja e inflacionit kudo në botë ka tronditur shumë ekonomi të

shteteve të zhvilluara, por edhe të atyre në zhvillim. Ekspertët e ekonomisë me renome ndërkombëtare

paralajmërojnë se viti 2026 do të jetë edhe më sfidues se viti 2008 në aspektin e ekonomisë globale. Vendet më pak të zhvilluara duhet të kenë prioritet zhvillimin ekonomik dhe gjetjen e modeleve ekonomike për të luftuar inflacionin që është shndërruar në kancer të zhvillimit ekonomik dhe standardit jetësor të qytetarëve. Bazuar në raportet e Bankës Botërore dhe FMN-së, Kosova ka një sistem bankar stabil, mirëpo bizneset alarmojnë se marrja e kredive është vështirësuar dhe dëshmon mungesën e likuiditetit bankar. Në këtë situatë Institucionet Mikrofinanciare dhe roli i tyre si shtyllë zhvillimore po rritet çdo ditë e më shumë. Në këtë kontekst, Institucionet Mikrofinanciare (IMF) nuk janë konkurrent i bankave, por kompletues i nevojshëm. Ato operojnë atje ku bankat nuk kanë motiv tregtar të shkojnë: në fshatra, në mikro-biznese, te fermerët e vegjël, gratë sipërmarrëse dhe të rinjtë që kanë ide, por jo mundësi. Ato nuk japin kredi për blerje të tokave urbane apo banesave

luksoze - ato japin kredi për sera me perime, një makinë qethjeje flokësh, një mjet pune apo një fillim biznesi në shkallë të vogël. Ky është kapitali që e gjallëron zhvillimin nga poshtë, që e kthen financën në mjet zhvillimi dhe jo vetëm në mekanizëm fitimi. Por për të funksionuar siç duhet, ky sektor ka nevojë për një ligj të qartë, të dedikuar dhe të drejtë. Prej vitesh kjo ka qenë një nevojë e njohur, por ende e paplotësuar. Pa një kuadër të mirëfilltë ligjor, IMF-të nuk mund të zhvillohen plotësisht, as të japin ndikimin që e dimë se mund ta japin. Sot është momenti që mikrofinanca të trajtohet si pjesë legjitime dhe strategjike e sistemit financiar, jo si përjashtim apo përjashtues. Kjo fillon me krijimin e një ligji që e njeh rolin e saj zhvillimor dhe e mbështet në mënyrë të qëndrueshme. Në fund të ditës, nuk mund të kemi një ekonomi gjithëpërfshirëse pa përfshirë edhe ata që bankat nuk arrijnë t’i prekin. IMF-të janë ura lidhëse. Dhe është koha t’u ndërtojmë themelet e duhura. Për një ekonomi të balancuar

është koha për një riorientim të ri. Në vend që të kemi një sistem ku bankat ndjekin fitimin, dhe IMF-të ndjekin zhvillimin, është koha që të gjithë aktorët të ndjekin një strategji të përbashkët zhvillimi. Bankat kanë burime, strukturë dhe ndikim - ato mund dhe duhet të bëhen pjesë aktive e financimit të ekonomisë reale. Të mbështesin edhe sektorë me kthim më të ngadaltë, por me ndikim të thellë: bujqësinë, ndërmarrjet prodhuese dhe sipërmarrjen e të rinjve. Ndërkohë, IMF-të duhet të fuqizohen, jo si alternativë, por si shtyllë strategjike për gjithëpërfshirje ekonomike. Një ekonomi e shëndetshme nuk matet vetëm me numrin e kredive të dhëna apo vlerën e tokës së shitur - por me mundësinë reale që i jep çdo qytetari për të ndërtuar, për të investuar dhe për të jetuar me dinjitet. Zhvillimi ekonomik i Republikës së Kosovës duhet të jetë prioritet i të gjithë akterëve relevantë bazuar në sundim të rendit, ligjit, mbështetjes institucionale si dhe pa dallime politike.

Shërbyesve publikë u dalin pagat me rritje për 55 euro

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se të enjten ka ekzekutuar pagat me

rritje prej 55 eurosh për 84 230 shërbyes publikë nëpër organizatat buxhetore. Sipas një postimi në rrjetin

social “Facebook” të faqes zyrtare të Ministrisë së Financave, bëhet me dije se kjo është faza e dytë e rritjes vjetore

prej 110 eurosh. “E ndarë në dy pjesë: +55 euro nga janari 2025, +55 euro nga korriku 2025”, thuhet në postim.



GAZA ‘PËRÇAN’ AMERIKËN ME ALEATËT E SAJ, EUROPA DHE KANADAJA I KTHEJNË SHPINËN TRUMP

Një përçarje e thellë po shfaqet mes SHBA-ve dhe aleatëve të saj tradicionalë mbi të ardhmen e Gazës dhe zgjidhjen e konfliktit izraelito-palestinez. Ndërsa Franca, Britania dhe Kanada janë shpallur planet për të njohur Shtetin e Palestinës, administrata e Donald Trump jo vetëm që refuzon të bashkohet, por edhe e bojkoton iniciativën diplomatike të udhëhequr nga Franca dhe Arabia Saudite në Kombet e Bashkuara.

Në konferencën e kësaj jave në Nju Jork, e mbajtur për të rigjallëruar zgjidhjen me dy shtete, Franca dhe Britania njoftuan se do të njohin Palestinën më vonë gjatë këtij viti, nëse përmbushen disa kushte. Kanada iu bashkua atyre të mërkurën. Por Shtetet e Bashkuara nuk morën pjesë. Zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Tammy Bruce, e quajti konferencën një “shfaqje për publikun” dhe tha se SHBA-të “nuk do të bëhen pjesë e kësaj fyerje”.

Në këtë sfond, lind pyetja thelbësore: A ka administrata Trump një plan për të ardhmen e Gazës?

Përgjigja duket të jetë jo, ose të paktën asnjë vizion të qartë e të qëndrueshëm.

Zyrtarët amerikanë i janë shmangur detajeve konkrete, ndërsa vetë presidenti ka kaluar nga ide radikale, si ajo për ta shndërruar Gazën në një “rivierë të Lindjes së Mesme”, në mungesë të plotë propozimesh realiste. Plani i përfolur për shpërnguljen e popullsisë palestineze është zbehur mes refuzimit të vendeve arabe dhe kritikave ndërkombëtare për shkelje të ligjit ndërkombëtar.

Në mungesë të një qasjeje strategjike nga SHBA-të, Europa dhe disa vende arabe po përpiqen të mbushin boshllëkun. Në konferencën e Nju Jorkut, u theksua nevoja për ndihmë emergjente humanitare, mbështetje për Autoritetin Palestinez dhe një kornizë të re për një marrëveshje paqeje. Kjo shënon një ndryshim të rëndësishëm nga praktika e deritanishme, sipas së cilës njohja e Palestinës do të ndodhte vetëm në fund të një procesi negociatash.

Ndërkohë, situata në Gaza është alarmante. OKB dhe organizatat



ndërkombëtare flasin për uri të përhapur, kequshqyerje dhe përkeqësim të kushteve sanitare. Izraeli fajëson Hamasin dhe Kombet e Bashkuara për krizën, por vendet evropiane e shohin qartë se zvarritja e ndihmave dhe politika e ndëshkimit kolektiv po e çojnë Gazën drejt katastrofës.

Për shumë vende, sidomos në Europë, skenat e fëmijëve të

qëlluar teksa kërkojnë ndihma humanitare janë bërë një pikë kthimi moral. Ministri i Jashtëm britanik, David Lammy, deklaroi se “komuniteti ndërkombëtar është thellësisht i tronditur nga pamjet e tmerrshme”.

Në mungesë të udhëheqjes amerikane, konferenca e shtatorit do të përpiqet të shtyjë përpara një proces të ri paqeje, me shpresën se bashkëpunimi i

vendeve arabe dhe presioni ndërkombëtar do të detyrojnë Uashingtonin të rikthehet në rrugën diplomatike. Por për momentin, vendi që dikur udhëhiqte përpjekjet për paqe në Lindjen e Mesme, po qëndron në heshtje, duke rrezikuar të humbasë ndikimin dhe kredibilitetin në një nga çështjet më të nxehta të politikës globale.

A I RREZIKOI TËRMETI NË KAMÇATKA NËNDETËSET BËRTHAMORE RUSE?

Një tërmet i fortë me magnitudë 8.8 ballë të shkallës Rihter tronditi gadishullin Kamçatka në lindje të Rusisë të mërkurën në mëngjes, duke ngritur pyetje serioze në lidhje me gjendjen e bazave kryesore të nëndetëseve bërthamore të Rusisë.

Tërmeti, i barazuar me të gjashtin më të fortë në historinë e regjistruar, goditi vetëm 75 milje nga Gjiri Avacha, ku ndodhen disa nga asetet bërthamore më strategjike të Marinës Ruse, duke përfshirë nëndetëset me raketa balistike të klasit Borei dhe Delta.

Edhe pse autoritetet ruse këmbëngulin se situata është nën kontroll, pa “të raportuara viktima ose lëndime serioze”, analistët ushtarakë dhe vëzhguesit ndërkombëtarë po japin alarmin për ndikimin e mundshëm në këto instalime detare të sigurisë së lartë.

“Nuk kam informacion se bazat detare të Marinës Ruse në Kamçatka kanë pësuar dëme kritike. Mendoj se gjithçka është brenda kufijve normalë,” tha një oficer në pension i Marinës Ruse, i njohur si @Capt_Navy në X, duke shtuar: “Këto baza u projektuan dhe u ndërtuan duke pasur parasysh mundësinë e një sulmi bërthamor nga armiku.”

Sipas britanikes Daily Mail, baza e nëndetëseve Rybachiy, e vendosur brenda Gjirit Avacha, është shtëpia e shumicës së nëndetëseve moderne ruse të raketave balistike bërthamore të



klasit Borei dhe Borei-A – shtylla kurizore e pengesës strategjike të Moskës. Anija më e vjetër Ryazan (K-44) e klasit Delta III mbetet gjithashtu në bazë, megjithëse statusi i saj aktual është i paqartë.

Ndërkohë që nuk ka raportime përfundimtare për dëme, pamjet e publikuara në internet tregojnë shkatërrime të mëdha në infrastrukturën civile në të gjithë Kamçatkën, duke përfshirë ndërtesa të shembura, porte të dëmtuara dhe rrugë të dëmtuara.

Në Petropavlovsk-Kamchatskiy, kryeqytetin e gadishullit dhe një tjetër qendër detare jetësore, një kopsht fëmijësh u shemb dhe disa persona u plagosën, sipas

zyrtarëve rusë.

“Fatkeqësisht, ka disa njerëz të plagosur gjatë ngjarjes sizmike,” tha Oleg Melnikov, ministri rajonal i shëndetësisë. Disa u lënduan ndërsa vraponin jashtë, dhe një paciente kërceu nga dritarja. Një grua u lëndua gjithashtu brenda terminalit të ri të aeroportit.

Vullkani Klyuchevskaya Sopka, një nga më aktivët në rajon, ka shpërthyer gjithashtu pas tërmetit, duke shtuar frikën për përçarje të mëtejshme dhe duke nxjerrë në pah brishtësinë e këtij cepi të paqëndrueshëm të Unazës së Zjarrit të Paqësorit. Paralajmërimi për cunami u lëshuan në një duzinë vendesh, përfshirë Japoninë, Kilin,

Perunë dhe Shtetet e Bashkuara, me valë mbi 1.5 metra të raportuara në Hawai. Analistët ushtarakë po shqyrtojnë tani imazhet e kufizuara satelitore dhe raportet kontradiktore në një përpjekje për të përcaktuar se cilat nëndetëse ishin të pranishme në Gjirin Avacha në kohën e tërmetit. Megjithatë, kushtet me re në rajon e kanë bërë të vështirë analizën.

Përveç flotës bërthamore Borei, baza është shtëpia e nëndetëseve me raketa të drejtuara (SSGN) të klasit Yasen-M dhe Oscar, ndër më të përparuarat në arsenalin e Marinës Ruse. Këto anije të armatosura konvencionalisht


përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm dhe statusi i tyre pas tërmetit është ende i panjohur.

Gjithashtu ka raportime se nëndetësja misterioze ruse K-329 Belgorod, nëndetësja më e gjatë në botë, mund të ketë bazën së shpejti në Gjirin Avacha. Nëndetësja, e cila mund të mbajë torpedo Poseidon me energji bërthamore, është gjithashtu e aftë të kryejë misione spiunazhi nënujor.

Ndërsa gjeografia e Gjirit të Avaçës mund të ketë ndihmuar në mbrojtjen e anijeve të ankoruara nga më e keqja e cunamit, edhe dallgët relativisht të vogla mund të jenë të dëmshme.

Ekspertët paralajmërojnë se nëndetëset që godasin pikat e tyre të ankorimit ose përmbytjet përmes kapakëve të hapur mund të shkaktojnë probleme serioze operacionale – veçanërisht nëse anijet janë duke u mirëmbajtur. Tërmeti goditi në orën 7:24 pasdite sipas kohës lindore, rreth 84 milje në lindje-juglindje të Kamçatkës, dhe ishte më i forti në nivel global që nga megatërmeti 9.1 ballë i Japonisë në vitin 2011, i cili la gati 20,000 të vdekur ose të zhdukur.

Edhe pse kërcënimi i menjëhershëm i cunamit është shpallur i përfunduar nga autoritetet ruse, ato paralajmërojnë se lëkundjet pasuese mund të përbëjnë ende rrezik.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

KUKA: NGA TË RINJTË PO KËRKOJMË REZULTATE, POR NUK PO U OFROJMË KUSHTE

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Pejë, 31 KORRIK - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka kërkuar nga institucionet shtetërore të krijojnë shkolla sportive që sportistët e rinj të aftësohen dhe të jenë në nivel ndërkombëtar. “Kosova, shteti ynë i ri, në krejt sportet ka një armatë të madhe të rinjsh, sidomos në grupmoshat e reja, e ne kemi obligim që ky numër të rritet më shumë, që fëmijët tanë të mos marrin rrugë të tjera pos edukimit e sportit që promovon shëndet! Gërshetimi i sportit me sistemin edukativ - shkolla, në shtete të Perëndimit, por jo vetëm, për talentët e moshave të shkollës së mesme janë ndërtuar përmes gjimnazëve sportive apo shkollave elitare sportive! Kosova po e ndien mungesën për diçka të tillë!”, ka thënë Kuka. Ai ka bërë me dije se bashkë me rektorin e UBT-së, Edmond Hajrizi, kanë nisur një nismë në këtë drejtim: “Me Rektorin e UBT Prof. Edmond Hajrizi kemi filluar një nismë për diçka të kësaj natyre. Talentët në çdo sport,



mosha 14-18, sot përballen me shumë probleme për të pasur karrierë sportive por edhe shkollim cilësor. Arsyeja: mungesat në mësim si shkak i udhëtimeve jashtë për Kampe Stërvitore!”. Trajneri Kuka ka theksuar se po kërkohen rezultate nga sportistët e rinj, por atyre nuk po u ofrohen kushtet e nevojshme për përgatitje cilësore. “Po kërkojmë rezultate por s’po u mundësojmë stërvitje elitare e edukim cilësor! Koha të reflektojmë, përndryshe rezultatet do jenë të zbehta për

talentët tanë. S’kemi nevojë të zbulojmë asgjë, pos të ndjekim shembuj të shteteve të fuqishme në sport! Shembulli më i mirë, shteti ynë mik Gjermania – shkolla më e fortë Elitare Sportive e Potsdamit ishte me komplet stafin dhe Kryetarin e qytetit në Pejë dhe na informuan për mënyrën si funksionojnë. Trajnerë të krejt sporteve, është koha të ngrehim zërin për sportistët tanë të rinj, t’u mundësojmë stërvitje e shkollim të nivelit të lartë!”, ka deklaruar Kuka.

SHKËNDIJA, KLUBI I TRETË SHQIPTAR NË FINALET E NJË KOMPETICIONI EVROPIAN

Tetovë, 31 KORRIK - Edhe pse u konsideruan thuajse pa gjasa përballë ish-kampionëve të Evropës, tetovarët nuk u ndalën fare nga emri i madh i Steaues së Bukureshtit. Shkëndija arriti ta mposhtë skuadrën rumune në të dyja ndeshjet e raundit të dytë kualifikues të UEFA Champions League (1-0 dhe 1-2), duke shkruar kështu një kapitull të ri në historinë e futbollit shqiptar. Deri në këtë fazë një sukses të tillë e ka arritur vetëm Skënderbeu i Korçës, në sezonet 2013/14 dhe 2015/16. Falë këtij suksesi, skuadra kuqezi nga Tetova tashmë e ka të siguruar pjesëmarrjen në fazën grupore të UEFA Europa Conference League, por ende ka shpresë për rezultate edhe më të mëdha. Në raundin e tretë të kualifikimeve të Ligës së Kampionëve, Shkëndija do të përballlet me Qarabagun nga Azerbajxhani. Nëse ia del ta kalojë edhe këtë pengesë, Shkëndija do të sigurojë një



vend në fazën grupore të UEFA Europa League, ndërsa do të ketë një mundësi historike për të arritur në fazën “play-off” të Ligës së Kampionëve, faza e fundit para grupeve të këtij kompeticioni më prestigjioz në Evropë. Deri më tani vetëm Skënderbeu ka arritur deri në këtë nivel, por është eliminuar nga gjiganti kroat Dinamo Zagreb, duke vazhduar më pas

në grupet e Europa League. Nga ana tjetër, ajo që Shkëndija tashmë e ka të sigurt, pjesëmarrjen në grupet e Conference League, është një sukses që e ka arritur dy herë edhe Ballkani i Suharekës, duke përfaqësuar denjësisht futbollin shqiptar në Evropë. Ndeshja e parë ndaj Qarabagut zhvillohet më 5 gusht në Shkup, ndërsa ajo e kthimit një javë më vonë.

SHKURT

Chelsea dhe Leverkuseni në garë për Jasharin

Chelsea dhe Bayer Leverkuseni kanë bërë propozime për të nënshkruar me objektivin e Milanit, Ardon Jashari, i cili ka pritur me padurim një transferim në “San Siro”. Për disa javë Milani është përpjekur të negociojë me Club Brugge për një marrëveshje për lojtarin e kombëtares zvicerane me vlerë 40 milionë euro. Ndërkohë, sipas raportimeve nga gazetari belg Sacha Tavorieri, Chelsea dhe Bayer Leverkusen janë duke u interesuar për Jasharin. Mediet kanë raportuar të enjten se Chelsea synon të paraqesë një ofertë për 23-vjeçarin, ndërsa Leverkuseni e sheh atë si një zëvendësim të mundshëm për Granit Xhakën, transferimi i përhershëm i të cilit te Sunderlandi u konfirmua të mërkurën.

Berisha: Daku është një nga sulmuesit më të mirë në Rusi

Ish-futbollisti i Akhmatit, Bernard Berisha, ka vlerësuar performancën e bashkëkombësit të tij Mirlind Daku në Rusi. Ish-futbollisti i Groznit e konsideron lojtarin shqiptar të Rubinit një nga sulmuesit më të mirë në Premierë Ligën Ruse (RPL). “Unë dhe Daku komunikojmë dhe ai është si një vëlla për mua. E kemi takuar njëri-tjetrin jashtë fushe disa herë. Mirlindi është një nga sulmuesit më të mirë në kampionatin rus dhe një lojtar shumë i rëndësishëm për Rubinin”, ka thënë Berisha për “Championat”. Berisha u largua nga Akhmati në verën e vitit 2025, një ditë para ndeshjes me Rubinin në Grozni. Shqiptari kishte luajtur për ekipin e Groznit që nga viti 2017. Daku luan për Rubinin sezonin e tretë. Gjatë dy kampionateve të mëparshme ruse, sulmuesi shqiptar shënoi 25 gola për ekipin e Kazanit.

Qatip Osmani, trajner i ri i Malishevës

FC Malisheva ka konfirmuar se trajneri i njohur Qatip Osmani është emëruar kryetrajner i ri i skuadrës. Klubi njoftoi arritjen e marrëveshjes me strategun tetovar, i cili ka ndërtuar një karrierë të pasur në futbollin e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, duke fituar trofe dhe respekt të gjerë në rajon. “Qatip Osmani, një nga emrat më të njohur të futbollit në rajon, ka lënë gjurmë të thella në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri, duke fituar trofe e duke ndërtuar sukses”, thuhet në njoftimin e Malishevës në “Facebook”. “Tani strategu tetovar i bashkohet Malishevës për ta udhëhequr ekipin tonë drejt objektivave të reja”.

Mitrovica eliminohet nga Liga e Kampionëve

Kampionia e Kosovës në futbollin e vajzave, KFF Mitrovica, nuk ka arritur të kalojë tutje në Ligën e Kampionëve, duke u eliminuar në gjysmëfinale të raundit të parë ndaj skuadrës nga Irlanda e Veriut, Cliftonville, me rezultat 3-1 pas vazhdimëve. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë, në kohën e rregullt u mbyll 1:1. Mitrovicaset ishin në rrugë të mirë drejt kalimit në finale, pasi deri në minutën e 84-t kishin epërsi me golin e Aurora Mulliqit, të realizuar në minutën e 47. Megjithatë, mysafiret në rastin e parë konkret barazuan shifrat, pas një gjuajtje nga këndi Carla Devine shënoi për 1:1 për ta çuar ndeshjen në vazhdimë. E më pas e njëjta lojtare shënoi edhe dy herë të tjera (100’ dhe 113’), duke i siguruar Cliftonvilleit kualifikimin në finalen e miniturneut kualifikues, ku do të ballafaqohet me skuadrën gjeorgjiane Lanchkhuti, në fundjavë, në stadiumin “Fadil Vokrri”.


Gyokeres: Kisha shumë oferta, por Arsenali ishte vendimi i duhur

LONDËR, 31 KORRIK - Viktor Gyokeres ka folur për herë të parë si lojtar i ri i Arsenalit dhe ka bërë të qartë se kalimi te klubi londinez ka qenë prioriteti i tij absolut. Sulmuesi suedez ka refuzuar ofertat nga Manchester Unitedi, Juventusi dhe disa ekipe nga Lindja e Mesme, duke theksuar se “Arsenali ishte ajo që doja që në fillim”.

“Pati opsione shumë të mira, në Angli dhe Itali, por që në momentin e parë ndjeva se Arsenali ishte vendimi i duhur. Nuk ishte aspak një zgjedhje e vështirë”, ka thënë Gyokeres. Pas dy sezoneve fantastike me Sporting Lisbonën dhe Kombëtaren e Suedisë, ku ka shënuar rreth 100 gola në total, kalimi i Gyokeres në Premierë Ligë nuk ishte i

lehtë. Ai u përball me tensione me klubin portugez, një gjobë të rëndë dhe kritika në rrjete sociale, pasi u akuzua se kishte ushtruar presion për largimin. “Muaji i fundit ka qenë veçanërisht i vështirë. Është folur shumë, shpesh pa e ditur realisht çfarë po ndodhte. Ishte një periudhë e lodhshme, por më forcoi si person. Si futbollist dua

gjithmonë të jem në nivelin më të lartë. E ndieja se isha gati për një tjetër sfidë, dhe këtë e dinin edhe te Sportingu”, ka thënë sulmuesi. Tek Arsenali, Gyokeres do ta mbajë fanellën me numrin 14, e njohur nga tifozët si numri i Thierry Henryt. Një përgjegjësi e madhe, por edhe një mundësi unike për të lënë gjurmë.



Osimheni llogaritet transferimi më i madh në historinë e Galatasarayt

STAMBOLL, 31 KORRIK - Festë e madhe në Turqi pas mbërritjes së Victor Osimhenit, që tashmë është vetëm një hap larg zyrtarizimit si futbollist i Galatasarayt. Ish-sulmuesi i Napolit mbërriti në Stamboll mbrëmjen e së mërkurës me një fluturim privat, në të cilin ndodheshin edhe Abdullah Kavukcu, zëvendëspresidenti ekzekutiv i klubit turk, dhe ndërmjetësi ndërkombëtar George Gardi, dy figura kyçe në përmbylljen e një negociate të gjatë e të ndërlikuar me Napolin. Në aeroportin e Stambollit, Osimhen u prit nga mijëra tifozë të Galatasarayt, të cilët i rezervuan një mikpritje madhështore. Emocionet nuk munguan as nga ana e lojtarit, i cili nuk e fshehu entuziazmin për këtë hap të ri në karrierën e tij. “Nuk di si t'i përshkruaj emocionet. Jam shumë i lumtur që jam kthyer në vendin që e dua”, ka deklaruar



Osimhen duke pozuar me shallin e Galatasarayt në duar. “Nëse më pyesni, tifozët e Galatasarayt janë më të mirët në botë. Mjafton ta shihni turmën që ka ardhur vetëm për një lojtar. Kjo tregon dashurinë që kanë për mua. Jam gati të jap gjithçka për suksesin e skuadrës këtë sezon të ri. Historia vazhdon, dhe jam i lumtur që e vazhdoj me Galatasarayn”.

Transferimi i Osimhenit konsiderohet goditja më e madhe në historinë e klubit turk si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në imazh. Të enjten Osimheni do t'u nënshtrohet vizitave mjekësore dhe më pas do ta firmosë kontratën e tij të re me Galatasarayn, duke hapur një kapitull të ri në karrierën e tij dhe në historinë e klubit turk.

Messi kritikon MLS-në: Nuk më lanë të luaj, ndikoi në formën time

MIAMI, 31 KORRIK - Lionel Messi ka shprehur pakënaqësinë ndaj Major League Soccer (MLS), pasi u pezullua një ndeshje (ndaj Cincinnati) si ndëshkim për mungesën në ndeshjen e All-Starit. Pezullimi e la jashtë fushës për një takim dhe, sipas argentinastit, kjo ndikoi negativisht në ritmin e tij, edhe pse Inter Miami fitoi 2-1 ndaj Atlas në Kupën e Ligave. “Në fillim isha pak i rëndë. Po luaja me vazhdimësi, por në ndeshjen ndaj Cincinnati nuk më lanë të luaja dhe sot e ndjeva këtë, sidomos në pjesën e parë”, u shpreh Messi. “Të mos luash, edhe pse në pamje të parë mund të duket më mirë, për mua është më keq, sepse kam



nevojë për vazhdimësi. Ndihehem më mirë fizikisht kur luaj ndeshje rregullisht dhe fitoj ritëm”, ka shtuar kapiteni i Miamit. Me gjithë mungesën e ritmit, Messi ishte përsëri vendimtar në fushë, duke dhuruar dy asistime, një për Telasco Segovia në minutën e 60 dhe një tjetër në minutat shtesë për Marcelo Weigandt (90+6'). Në përfundim

të deklaratës së tij, Messi foli edhe për debutimin e mikut të tij të ngushtë dhe bashkëkombësit Rodrigo De Paul, i cili bëri ndeshjen e parë me Inter Miamin. “E njohim njëri-tjetrin prej kohësh. Kemi luajtur shumë ndeshje bashkë. Ai sjell një hap cilësor në skuadër. Erdhi me shumë dëshirë dhe sot, pavarësisht se kishte bërë pak stërvitje, dha gjithçka në fushë. Është e vështirë të vraposh këtu, me këtë vapë, lagështi dhe temperatura të larta”, ka shtuar Messi. Përkundër kritikave, Messi vazhdon ta udhëheqë Inter Miamin me ndikimin e tij të jashtëzakonshëm në fushë dhe jashtë saj.

SHKURT

Presidenti i Steauas: Nëse na eliminon Drita, atëherë ta lëmë futbollin

Skuadra kampione e Kosovës, Drita, do të përballlet me gjigantin rumun FCSB (ish-Steaua Bukuresht) në raundin e tretë të UEFA Europa League. Ky duel pritet të jetë një sfidë e fortë dhe me peshë të veçantë për të dyja skuadrat si në aspektin sportiv, po ashtu edhe në atë emocional. Presidenti kontrovers i FCSB-së, Gigi Becali, ka bërë një deklaratë të pazakontë para përballjes me ekipin nga Gjilani. I njohur për qëndrimet e tij të ashpra dhe deklaratat e bujshme, ai u shpreh se një eliminim nga Drita do të ishte i papranueshëm për klubin rumun. “Nëse Kosova, nga vjen kundërshtari ynë i radhës, Drita, na mund, atëherë le ta lëmë futbollin. Nuk dua ta bëj këtë, por kështu duhet të jetë. Nuk mendoj se jemi më të dobët se ata”, ka deklaruar Becali, i ndikuar edhe nga eliminimi i fundit që FCSB pësoi ndaj një tjetër skuadre shqiptare, Shkëndija e Tetovës. Kampionët e Kosovës po kalojnë një formë të mirë dhe synojnë të bëjnë historinë duke kaluar në fazën “play-off” të Europa League. Nëse arrin ta eliminojë FCSB-në, Drita do ta ketë të siguruar pjesëmarrjen në fazën e grupeve të UEFA Conference League, ndërkohë që do ta vazhdojë garën edhe në “play-off” të Europa League. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 7 gusht në Bukuresht, në stadiumin e FCSB-së, ndërsa takimi i kthimit do të luhet një javë më pas në Prishtinë.

‘Jeta private e ndërlikuar’, Hamiltoni: Karriera mbi gjithçka

Legjenda e Formulës 1, Lewis Hamilton, ka zbuluar së fundmi se ka bërë një zgjedhje të vetëdijshme në jetën e tij, ta vendosë karrierën dhe suksesin në pistë përpara jetës personale dhe marrëdhënieve romantike. Që prej lidhjes së Hamiltonit me këngëtaren e famshme Nicole Scherzinger, 40-vjeçari nuk ka dalë kurrë publikisht me një të dashur të re. Pas një romance me ulje-ngritje që zgjati shtatë vjet, çifti vendosi t'i japë fund përfundimisht marrëdhënies së tyre në vitin 2015. Që prej atëherë jeta e tij romantike ka qenë e paqartë, ndërkohë që ylli i F1 ka fituar katër nga shtatë kampionatet e tij botërore pas ndarjes. Së fundmi, thashethemet se ai është në një lidhje me këngëtaren pop Raye janë shtuar, pasi kjo e fundit është parë në garazhin e Ferrari në Silverstone. Por, në një intervistë për median franceze RTBF, Hamiltoni është shprehur se e ka lënë mënjanë jetën e dashurisë prej kohësh, pasi është diçka “shumë e ndërlikuar” për t'u menaxhuar në ditët e sotme. “Po, është shumë e ndërlikuar, sidomos në botën e sotme. Shoh pilotë të tjerë dhe pyes veten si ia dalin. Disa janë të martuar, kanë fëmijë apo të dashura. Unë kam zgjedhur ndryshe të përqendrohem maksimalisht te koha që kam këtu, sepse është më e shkurtër sesa mendon”, ka thënë Hamiltoni.

Verratti: Messi erdhi te PSG-ja, pas darkës në Ibiza me Neymarin

Marco Verratti, i cili tani luan tek Al-Duhail në Katar, foli për mënyrën se si e përjetoi mbërritjen e papritur të Lionel Messit te Paris Saint Germaini në vitin 2021. Sipas mesfushorit italian, gjithçka filloi në një

natë vere: “Ishim në Ibiza dhe Neymari më tha se do të shkonim për darkë me Messin. Di Maria dhe Leandro Paredes ishin atje. Folëm, qeshëm, folëm për klubin, por asgjë nuk tregonte se do të ndodhte

diçka. Të nesërmen lindën probleme me Barcelonën dhe, disa orë më vonë, Neymari më telefonoi për të më thënë se Messi do të vinte të luante me ne. Ishte magjike”, ka thënë italianin në një intervistë me “La

Gazzetta dello Sport”. Verratti, i cili kaloi 11 sezone në Paris, mohoi se u largua nga Luis Enrique, trajneri aktual i PSG-së: “Unë isha ai që kërkova të largohesha. I shpreha Nasser Al-Khelaifi, presidentit të PSG-

së, dëshirën time për të ndërmarrë sfida të reja”. Lidhur me Kylian Mbappen, i cili tani është te Real Madridi, 32-vjeçari italian bëri të qartë: “Herët a vonë, ai do ta fitojë “Topin e Artë”.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master
1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA
1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Motel Paris” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811256587 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Motel Paris” D.O.O. Fushë Kosovë donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811256587 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Motel Paris” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 811256587 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vullnet Brahimaj shpall të humbur Arken Fiskale me nr. 06603761 në Prizren.

- GSH Services SH.P.K. shpall t6ë pavlefshme numrin unik identifikues 812245927 të lëshuar nga ARBK.

- Florjana Ndrecaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe certifikatën diplomën e shmm “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- D.P.H “Namiku” Rahovec shpall të pavlefshme numrin unik identifikues 810393570 të lëshuar nga ARBK.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterinikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

